



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

Date 13.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Sherbim implementimi ISO 27001

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

sherbime it; konsulence, zhvillim i softwareve, internet dhe sherbimet e suportit

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,498,333 (nje milion e katerqind e nentedhjete e tete mije e treqind e tridhjete e tre) leke pa TVSH
Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKSH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

TERMAT E REFERENCES

HYRJE

Në kuadër të rritjes së nivelit të sigurisë së informacionit dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore që burojnë nga Ligji nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, si dhe aktet nënligjore të miratuara nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKSK), Ujesjellsi Shkodër synon ngritjen dhe implementimin e një kuadri të plotë organizativ dhe procedural për administrimin e sigurisë së informacionit.

Gjatë auditimit të realizuar nga AKSK janë evidentuar mangësi të konsiderueshme në aspektin organizativ, procedural dhe dokumentar, të cilat lidhen kryesisht me:

- mungesën e politikave të formalizuara të sigurisë së informacionit;
- mungesën e procedurave për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike;

- mungesën e planeve të vazhdimësisë së punës dhe rikuperimit nga fatkeqësitë;
- mungesën e mekanizmave për menaxhimin e riskut kibernetik;
- mungesën e dokumentimit të proceseve të kontrollit të aksesit dhe menaxhimit të aseteve;
- mungesën e strukturave dhe roleve të përcaktuara për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

Në kushtet e transformimit digjital të administratës publike dhe rritjes së numrit të incidenteve kibernetike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ngritja e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) konsiderohet një domosdoshmëri funksionale, ligjore dhe strategjike për garantimin e integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së informacionit institucional.

Ky projekt synon jo vetëm përmbushjen formale të kërkesave ligjore dhe rekomandimeve të auditimit, por edhe krijimin e një infrastrukture organizative të qëndrueshme, e aftë për të garantuar mbrojtjen e të dhënave dhe vazhdimësinë e shërbimeve publike në çdo situatë operacionale apo emergjente.

2. QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi kryesor i projektit është realizimi i auditimit organizativ dhe funksional të sigurisë së informacionit, si dhe ngritja e kuadrit të nevojshëm dokumentar dhe procedural për implementimin e standardit ISO/IEC 27001 në Ujesjells Shkodër.

Objektivat specifikë të projektit janë:

- Garantimi i përputhshmërisë së institucionit me kërkesat e Ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”;
- Përmbushja e rekomandimeve dhe gjetjeve të auditimit të AKSK;
- Ngritja dhe implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI);
- Hartimi dhe standardizimi i dokumentacionit sipas praktikave të ISO/IEC 27001;
- Krijimi i procedurave të kontrollit, monitorimit dhe reagimit ndaj incidenteve;
- Rritja e nivelit të mbrojtjes së sistemeve, rrjeteve dhe të dhënave personale;
- Garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve publike në rast incidentesh apo sulmesh kibernetike;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe kulturës organizative të sigurisë tek stafi i institucionit;
- Krijimi i një strukture të qëndrueshme për menaxhimin e riskut kibernetik dhe kontrollit të aksesit.

3. ARGUMENTIMI DHE NEVOJA PËR NDËRHYRJE

Në kushtet aktuale të rritjes së ekspozimit të institucioneve publike ndaj sulmeve kibernetike, mungesa e një sistemi të standardizuar të menaxhimit të sigurisë së informacionit përbën një risk të lartë institucional.

Mosimplementimi i masave organizative dhe procedurale sjell pasoja të drejtpërdrejta në:

- funksionimin normal të institucionit;
- ofrimin e shërbimeve publike;
- mbrojtjen e të dhënave personale;
- integritetin e sistemeve informative;
- reputacionin institucional;
- përputhshmërinë ligjore dhe rregullatore.

3.1 Rreziqet ligjore dhe administrative

Mosplotësimi i kërkesave të Ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, Ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe akteve nënligjore të AKSK mund të sjellë:

- masa administrative dhe gjoba;
- përgjegjësi institucionale dhe administrative;
- kufizime në përdorimin e sistemeve kritike;
- detyrime shtesë monitorimi nga autoritetet mbikëqyrëse;
- cenim të besueshmërisë institucionale.

3.2 Rreziku operacional dhe ndërprerja e shërbimeve

Mungesa e planeve të vazhdimësisë së punës, procedurave të backup-it dhe planeve të rikuperimit nga fatkeqësitë teknologjike rrit ndjeshëm riskun e:

- ndërprerjes së sistemeve elektronike;
- bllokimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- humbjes së aksesit në të dhëna kritike;
- vonesave administrative dhe operative.

3.3 Rreziku i komprometimit të informacionit

Mungesa e kontrolleve të aksesit dhe procedurave të sigurisë ekspozon institucionin ndaj:

- aksesit të paautorizuar;
- rrjedhjes së të dhënave personale;
- manipulimit ose humbjes së informacionit;
- sulmeve ransomware dhe phishing;
- komprometimit të sistemeve kritike.

3.4 Nevoja për standardizim sipas ISO/IEC 27001

Standardi ISO/IEC 27001 përfaqëson praktikën ndërkombëtare më të njohur për ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.

Implementimi i këtij standardi garanton:

- qasje të standardizuar ndaj menaxhimit të sigurisë;
- dokumentim të plotë institucional;
- monitorim dhe auditim të vazhdueshëm;
- gjurmueshmëri dhe kontroll të proceseve;
- përmirësim të vazhdueshëm të masave të sigurisë.

4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti i projektit konsiston në realizimin e auditimit organizativ të sigurisë së informacionit dhe hartimin e paketës së plotë të dokumentacionit për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI).

Projekti përfshin:

- analizimin e gjendjes aktuale të sigurisë së informacionit;
- identifikimin e risqeve dhe mangësive organizative;
- hartimin e politikave dhe procedurave;
- implementimin e mekanizmave të kontrollit;
- asistencën për përputhshmëri me AKSK;
- trajnimin dhe ndërgjegjësimin e stafit.

Dokumentacioni që do të hartohet

1. Politika e Sigurisë së Informacionit;
2. Procedura për Menaxhimin e Riskut Kibernetik;
3. Procedura të Sigurisë Organizative;
4. Politika për Menaxhimin e Aksesit dhe Identiteteve;
5. Procedura për Menaxhimin e Aseteve Informative;
6. Procedura për Menaxhimin e Incidenteve Kibernetike;
7. Plane të Vazhdimësisë së Punës dhe Disaster Recovery;
8. Procedura për Backup dhe Rikuperim të të Dhënave;
9. Politika për përdorimin e pajisjeve dhe sistemeve informative;
10. Procedura për menaxhimin e palëve të treta dhe ofruesve të shërbimeve;
11. Regjistra dhe matrica të riskut;
12. Dokumentacion mbështetës sipas kërkesave të AKSK dhe ISO/IEC 27001.

5. PLANI I IMPLEMENTIMIT

Faza	Afati	Aktivitetet Kryesore
Faza I	Java 1–2	Analiza fillestare, mbledhja e informacionit, identifikimi i proceseve dhe analizimi i gjetjeve të auditimit
Faza II	Java 3–4	Analiza e riskut kibernetik dhe identifikimi i kontrolleve të nevojshme
Faza III	Java 5–7	Hartimi i politikave, procedurave dhe dokumentacionit të SMSI
Faza IV	Java 8	Rishikimi teknik dhe ligjor i dokumentacionit
Faza V	Java 9	Miratimi institucional i dokumentacionit

Faza	Afati	Aktivitetet Kryesore
Faza VI	Java 10–12	Trajnimi i stafit dhe ndërgjegjësimi mbi procedurat dhe kontrollet e sigurisë

6. REZULTATET E PRITSHME

Në përfundim të projektit, Ujesjellsi Shkodër pritet të disponojë:

- Sistem të standardizuar të menaxhimit të sigurisë së informacionit;
- Paketë të plotë dokumentacioni sipas ISO/IEC 27001;
- Strukturë organizative për menaxhimin e sigurisë kibernetike;
- Procedura të standardizuara për reagimin ndaj incidenteve;
- Plane operative për vazhdimësinë e punës;
- Regjistër të aseteve informative dhe matrica të riskut;
- Nivel më të lartë mbrojtjeje për të dhënat dhe sistemet;
- Rritje të kapaciteteve të stafit në fushën e sigurisë kibernetike;
- Përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës (vlera e fondit limit)

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 55, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2021, 2022 dhe 2023, që rezulton të jenë përmbullur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor.

Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të balanceve të tre viteve të fundit për vitet 2022, 2023, 2024, si mbas xhirove vjetore, të depozituar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Paraqitja e balanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së balanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj. Po kështu, duke qenë se mund të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Sherbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vertetuar me dokumentacionin vertetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatorëve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses, vlera është e përcaktuar me VKM .

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë,
- ISO 27001-2022 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme vendosur bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Keto kritere janë gjykuar si të domosdoshme, pasi keto certifikata ka të bëjnë me tre elemente shumë të rëndësishme:

ISO 9001: Cilësia e kryerjes së shërbimit; shërbimet autoritetit kontraktor për të garnatuar se operatorët ekonomik ofertues janë të certifikuar për të kryer shërbime me cilësi sipas standarteve ISO 27001-2022 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit; shërbimet autoritetit kontraktor për të garnatuar se operatorët ekonomik ofertues janë të certifikuar në menaxhimin e sigurisë së informacionit.

2.3.3 Për shkak të natyrës kritike të projektit dhe kompleksitetit teknik të shërbimit operatori ekonomik duhet të disponojë staf të specializuar dhe të certifikuar në fushat përkatëse si me poshte:

1. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist I certifikuar në Siguri Kibernetike, Teknologji Informacioni ose fusha ekuivalente.

Ky ekspert do të jetë përgjegjës për:

- analizimin e arkitekturës së sigurisë;
- identifikimin e risqeve teknike;
- hartimin e kontrolleve të sigurisë;
- implementimin e praktikave sipas ISO/IEC 27001;
- përafrimin e kërkesave të AKSK me proceset institucionale.

Prania e këtij eksperti konsiderohet thelbësore për shkak të kompleksitetit teknik të projektit dhe nevojës për ekspertizë të avancuar në fushën e sigurisë së informacionit.

2. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) Project Manager të certifikuar.

Ky rol është i nevojshëm për:

- koordinimin e aktiviteteve të projektit;
- menaxhimin e afateve dhe deliverables;
- monitorimin e implementimit;
- komunikimin institucional;
- garantimin e realizimit të projektit sipas standardeve të përcaktuara.

Menaxhimi korrekt i projektit është faktor kyç për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist I certifikuar Threat Hunter ose Cyber Threat Analyst.

Këta ekspertë do të kontribuojnë në:

- identifikimin e kërcënimeve të avancuara;
- analizimin e incidenteve potenciale;
- ndërtimin e mekanizmave të monitorimit;

- hartimin e procedurave të reagimit;
- analizimin e indikatorëve të komprometimit.

Kjo kërkesë konsiderohet e domosdoshme për shkak të nivelit të lartë të ekspozimit të institucioneve publike ndaj sulmeve kibernetike.

4. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist të certifikuar për sigurinë e rrjetit.

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

- analizimin e infrastrukturës së rrjetit;
- identifikimin e dobësive teknike;
- hartimin e masave të segmentimit dhe mbrojtjes së rrjetit;
- përcaktimin e kontrolleve të aksesit dhe komunikimit.

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist të certifikuar MCSE ose ekuivalent.

Kjo kërkesë justifikohet nga fakti se infrastruktura e institucioneve publike mbështetet kryesisht në:

- Microsoft Active Directory;
- Windows Server;
- Microsoft Exchange;
- platforma Microsoft për administrimin e përdoruesve dhe aksesit.

Eksperti do të asistojë në implementimin e kontrolleve të sigurisë në ambientet Microsoft.

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) auditues të certifikuar ISO/IEC 27001.

Ky ekspert garanton:

- përputhshmërinë e dokumentacionit me standardin;
- auditimin e proceseve të sigurisë;
- identifikimin e mospërputhjeve;
- rekomandimet për përmirësim të vazhdueshëm.

7. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) auditues të certifikuar ISO 9001.

Ky ekspert do të kontribuojë në:

- standardizimin e proceseve;
- garantimin e cilësisë së dokumentacionit;
- implementimin e praktikave të menaxhimit të cilësisë;
- përmirësimin e proceseve institucionale.

8. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist I certifikuar Incident Response.

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

- hartimin e procedurave të reagimit ndaj incidenteve;
- analizimin e skenarëve të sulmeve;
- koordinimin e masave emergjente;
- përcaktimin e proceseve të raportimit dhe rikuperimit.

9. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) një trajner të certifikuar I cili do zhvillojë trajnimet e stafit.

Ky kriter siguron që:

- trajnimet të zhvillohen nga personel me kompetencë të verifikuar;
- stafi i autoritetit kontraktor të marrë njohuri të sakta dhe të përditësuara;
- të minimizohen risqet që lidhen me zbatimin jo korrekt të kërkesave të standardit

Shënim: *Kerkesat e mesiperme ne lidhje me stafin përmbushen nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.*

Argumentimi

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar zërave të preventivit dhe termave të references të objektit për realizimin e

kontrates ne mbeshtetje te pikës 4 të Nenit 77 te Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje te Nenit 39 te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Ne rastin konkret është e domosdoshme stafi i specializuar pasi kemi te bejme me nje proces sherbimi qe kerkohen njohuri specifike per te gjithë procesin.

Në konsideratë te përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Njesia e Prokurimit